



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3797/5 Prot.

Pogradec, më 29.09. 2023

VENDIM

NR. 99, DATË 27.09.2023

MIRATIMI I RENDIT TË DITËS SË Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, Ligji
139/2015

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi shqyrtoi me këshilltarët dhe miratoi propozimet e paraqitura si dhe pikat e rendit të ditës të njoftuara për vendimarrje në njoftimin për mbledhjen e datës 27.09.2023, në mbështetje të ligjit nr 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 54, gërma k, si dhe neni 97, pika 2 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK


VENDOSI:

1. Të miratojë rendin e ditës me ndryshime për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Pogradec sipas njoftimit bashkëlidhur
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3797 /₃ prot.


Pogradec më, 19.09.2023

LËNDA: Njoftim për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Pogradec

Të nderuar!

Ju njoftojmë se ditën e Mërkurë më date 27.09.2023, ora 12:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Pogradec zhvillohet mbledhja e rradhës e Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetarja e Këshillit në bazë të ligjit 139/2015, neni 53 pika 4, dhe Regullores së Këshillit Bashkiak nr 40 datë 05.03.2020 me këtë rend dite :

1. **Projekt – vendim :** Miratimi I Rendit të ditës.
2. **Projekt – vendim:** Miratimi I Procesverbalit të dates 28.08.2023.
3. **Projekt – vendim:** Një ndryshim në përbërjen e Këshillit të Bashkisë Pogradec.
4. **Projekt – vendim:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike për periudhën Gusht 2023.
5. **Projekt – vendim:** Për ngritjen e komisionit të strehimit për vitin ushtrimor 2023-2024 sipas ligjit nr 22/02018 me disa ndryshime me ligjin nr 48/2023 datë 22.06.2023
6. **Projekt – vendim:** Zgjerimin e sipërfaqes së varrezave publike për qytetin në fshatin Guras dhe blerjen e sipërfaqes së tokës së nevojshme për funksionimin e këtij shërbimi.
7. **Projekt – vendim:** Për miratimin në parim të dhënies në përdorim, për ndërtim aerogjeneratorët, fotovoltaikë (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse), në pasurinë me sipërfaqe totale 13.2500 (trembëdhjetë presje dy mijë e pesëqind) ha .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

8. **Projekt – vendim:** Për disa shtesa në VKB nr 56 datë 19.06.2023 “Për krijimin e komisioneve të përhershme të Këshillit të Bashkisë Pogradec ”
9. **Projekt – vendim:** Për një ndryshim në vendimin nr 53 datë 15.06.2023 të Këshillit Bashkiak “Për zgjedhjen e përfaqësuesve të Këshillit të Bashkisë Pogradec në Këshillin e Qarkut Korçë ”
10. Të tjera

SEKRETARE E KËSHILLIT

Jona BOJKO

Shënim: Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit janë si më poshtë: Komisioni I Mandateve, Rregulloreve, Ceshetjeve Juridike, Qeverisjes së Mire, Administrates, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare, I Etikës, Konfliktit të Interesit, Standarteve dhe Apelimeve. Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiakë, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikeqyrjes Financiare, I Ekonomise Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural, Komisioni I Sigurise Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit, I Qeverise Elektronike dhe Teknologjise se Informacionit ditën e Marte ,dt 26.09.2023, ora : 13:00 për pikat 1,2,3,4 ,5,6,7,8 te rendit të ditës,në Sallën e Këshillit Bashkiak.